

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI JURIDIK**

**DEPARTAMENTI NDËRKOMBËTAR**

**PROGRAMI MASTER**



## **PUNIM I DIPLOMES MASTER**

**TITULLI I PUNIMIT: “E Drejta Sportive në Kosovë: rruga drejt arritjes së standardeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit për Sport CAS”**

**MENTOR:**

**Prof.Dr. Hajredin Kuçi**

**KANDIDATI:**

**Visar Alimehaj**

Prishtinë, 2022

## PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	4
Falënderim dhe mirënjohje	6
ABSTRAKT	7
METODOLOGJIA E PUNIMIT	10
STRUKTURA E PUNIMIT	12
HYRJE	14
<b>Kapitulli I</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
ARBITRAZHI SPORTIV NË KOSOVË	17
I.1. Format organizative të sportit në Kosovë	17
I.2. Organizimi në aspektin disiplinor	21
I.3. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv në Kosovë – GjAS	27
I.4. Baza ligjore e GjAS-it	33
<b>Kapitulli II</b>	<b>Error! Bookmark not defined.8</b>
ARBITRAZHI NDËRKOMBËTAR SPORTIV	38
II.1. Arbitrazhi sportiv në vendet e rajonit	38
II.1.a. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv në Shqipëri – KAS	38
II.1.b. Arbitrazhi Sportiv i Malit të Zi	39
II.1.c. Arbitrazhi i Përhershëm Sportiv i Serbisë – SSA	39
II.1.d. Arbitrazhi Sportiv në Maqedoninë e Veriut – SAS	40
II.2. Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar Sportiv në Llozanë – CAS	40
II.2.a. Historiku i formimit dhe i zhvillimit të CAS-it	40
II.2.b. Organizimi	42
II.3. Këshilli Ndërkombëtar i Arbitrazhit Sportiv – ICAS	43
II.4. Divizionet e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv – CAS	44
II.4. a. Divizioni i Arbitrazhit të Zakonshëm	44
II.4. b. Divizioni i Antidopingut	44
II.4. c. Divizioni i Arbitrazhit të Apelit	44
II.4. d. Procedura e ndërmjetësimit	45
<b>Kapitulli III</b>	<b>Error! Bookmark not defined.6</b>
RREGULLAT PROCEDURALE TË KODIT TË CAS-it	46

III.1. Dispozitat e përgjithshme	47
III.1.a. Neni R27 – Zbatimi i rregullave	50
III.1.b. Neni R28 – Selia	52
III.1.c. Neni R29 – Gjuha	53
III.1.d. Neni R30 – Përfaqësimi dhe ndihma	55
III.1.e. Neni R31 – Njoftimet dhe komunikimet	55
III.1.f. Neni R32 – Afatet kohore	56
III.1.g. Nenet R33, 34, 35 dhe 36 – Arbitrat	56
III.1.h. Neni R37 – Masat e përkohshme dhe konservatore	57
III.2. Dispozitat e veçanta të zbatueshme për procedurën e arbitrazhit të zakonshëm dhe të arbitrazhit të apelit	58
III.2.a. Neni R40 – Arbitrat, formimi i kolegjeve dhe nominimi i arbitrave	59
III.2.b. Zbatimi i vendimeve të CAS-it	60
III.2.c. Anulimi i vendimeve të CAS-it	61
III.2.d. Kostot procedurale	60
<b>Kapitulli IV</b>	65
<b>ORGANIZATAT SPORTIVE NË KOSOVË DHE E DREJTA NDËRKOMBËTARE</b>	65
IV.1. Ndarja dhe kategorizimi i organizatave sportive, i trajnerëve dhe i sportistëve në Kosovë	66
IV.2. Mosmarrëveshjet e organizatave sportive kosovare me drejtësinë ndërkombëtare	67
VI.2.a. KV Peja dhe CEV	68
IV.2.b. KB Peja dhe FIBA – Arsic, Austin & Smith, BAT 0944/16	70
VI.2.c. FC Drita dhe UEFA	71
VI.3. Triumfet diplomatike përmes sportit	76
Konkluzionet	82
BIBLIOGRAFIA	84

## SHKURTESAT

<b>OS</b>	Organizata sportive
<b>KOK</b>	Komiteti Olimpik i Kosovës
<b>FVK</b>	Federata e Volejbollit e Kosovës
<b>CAS</b>	Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit Sportiv
<b>ICAS</b>	Këshilli i Arbitrazhit Ndërkombëtar Sportiv
<b>IOC</b>	Komiteti Olimpik Ndërkombëtar
<b>FEI</b>	Federata Ndërkombëtare e Garave me Kuaj
<b>GjAS</b>	Gjykata e Arbitrazhit Sportiv në Kosovë
<b>FS</b>	Federatë sportive
<b>WADA</b>	Organizata Botërore e Antidopingut
<b>KOS-ADA</b>	Agjencia Kosovare e Antidopingut
<b>LO</b>	Lojërat Olimpike
<b>LA</b>	Ligji i Arbitrazhit
<b>OJQ</b>	Organizata joqeveritare
<b>KOKSH</b>	Komiteti Olimpik i Shqipërisë
<b>COK</b>	Komiteti Olimpik i Malit të Zi
<b>SSA</b>	Arbitrazhi i Përhershëm Sportiv i Serbisë
<b>FC</b>	Klubi futbollit

<b>UEFA</b>	Unioni i Shoqatave Evropiane të Futbollit
<b>KAS</b>	Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (në Shqipëri)
<b>SAS</b>	Gjykata e Arbitrazhit Sportiv (në Maqedoninë e Veriut)
<b>MOK</b>	Komiteti Olimpik i Maqedonisë së Veriut
<b>IF</b>	Federatë ndërkombëtare
<b>NOC</b>	Komitetet Olimpike Kombëtare
<b>KV</b>	Klubi i volejbollit
<b>KB</b>	Klubi i basketbollit
<b>MKRS</b>	Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit
<b>KD</b>	Komisioni disiplinor
<b>CEV</b>	Konfederata Evropiane e Volejbollit
<b>BAT</b>	Arbitrazhi Evropian i Basketbollit
<b>PILA</b>	E Drejta Ndërkombëtare Private Zvicerane
<b>SFT</b>	Gjykata Supreme e Zvicrës
<b>FAMMK</b>	Federata e Arteve Mikse Marciale e Kosovës
<b>FFK</b>	Federata e Futbollit e Kosovës

## Falënderim dhe mirënjohje

*Mirënjohja është memorie e zemrës*

Jean Baptiste Massieu

Puna ime një vjeçare pa periudha pushimi u realizua duke u mbështetur dhe ndihmuar nga njerez profesional, e të cilët dëshiroj t'i falënderoj dhe t'u shpreh mirënjohjen time.

Shpreh mirënjohje për mentorin tim prof. H Jaredin Kuci i cili gjithnjë pati mirkuptim dhe më përkrahi në realizimin e këtij punimi.

Në mënyrë të veçantë falënderoj prof. ass. dr. Donikë Qerimin, në konsultim me të cilën kam zgjedhur këtë temë dhe, për më tepër, gjatë gjithë procesit të realizimit të këtij punimi më ka ndihmuar me këshillat e saj profesionale.

Mirënjohje të thellë për mikun e fëmijërisë sime, prof. ass. dr. Isuf Jahmurataj, i cili më ka udhëzuar rreth realizimit të këtij punimi.

Falënderoj presidentin e Komitetit Olimpik të Kosovës, z. Besim Hasani, i cili pa përtesë e në çdo kohë u është përgjigjur pyetjeve që ia kam drejtuar.

Dhe gjithashtu pazezerve u shpreh mirënjohje prindërve të mi, që më kanë përkrahur në çdo iniciativë timen profesionale, morale dhe motivuese.

Së fundmi shpreh falenderimet për bashkëshorten time, e cila më është gjendur pranë me sygjerime dhe duke më mbështetur moralisht gjatë tërë kohës të cilën e kam shfrytëzuar që ky punim në fund te jetë në duart e lexuesve.

Visar Alimehaj

## ABSTRAKT

Sporti është aftësi dhe aktivitet fizik gjatë të cilit personi apo ekipi garon për argëtim apo garim duke shfrytëzuar aftësitë e tija apo të tyre psikofizike. Dhe me këtë duke qenë kategori dinamike dhe multidisiplinare është paraqitur nevoja që të rregullohet edhe aspekti normativ i të drejtave dhe detyrimeve në sport, por edhe aspekti i disiplinimit të aplikuesve të sportit dhe mekanizmave sportivë.

Të drejtat dhe detyrimet duke qenë të normuara, ato mund të kualifikohet si *e drejtë sportive (Lex Sportiva)*. Pra, me të drejtën sportive mundë të kuptojmë tërësinë e normave juridike qofshin ato ligje që e rregullojnë organizimin e sportit në përsona fizik dhe juridik, rregullore që e rregullojnë lojen apo të drejtat dhe detyrimet e sportistëve dhe palëve tjera të interesit si dhe praktika dhe jurisprudenca gjyqësore dhe ajo e arbitrazhit mbi të. Lidhur me këtë autori Ken Foster thotë se “Lex Sportiva (E drejta sportive) është drejtësi private e krijuar nga organizatat globale të sportit dhe jashtë rrezes së shqyrtimit gjyqësor të gjykatave kombëtare apo shtetërore.”

Edhe pse në 30 vitet e fundit ka krijuar normë të re si në Evropë ashtu edhe në nivel botëror, e drejta sportive ka evoluar me hapa të shpejtë. Edhe në Kosovë, brenda mundësive dhe kushteve, sporti është zhvilluar dhe është avancuar, ndonëse jo në nivelin e duhur karshi potencialit njerëzor që posedon. Krahas zhvillimit të sportit, në një aspekt kemi edhe zhvillim dhe avancim të asaj që definohet si *e drejtë sportive* në Kosovë, edhe pse jo sipas një tretmani të duhur sepse sa i përket arbitrazhit sportiv, duhet thënë se në Kosovë ka mungesë të literaturës. GjAS-i ende nuk ka rregullore të mirefillt apo kod të arbitrazhit sportiv, kurse literatura në gjuhën shqipe lidhur me Arbitrazhin Ndërkombëtar Sportiv – CAS mungon në përgjithësi.

Pas pranimit të KOK-ut dhe OS-ve (federatave) të Kosovës në institucionet ndërkombëtare të sportit, sporti në Kosovë ka avancuar në aspektin profesional. Anëtarësimi në mekanizmat ndërkombëtarë të sportit e ka obliguar Kosovën që të zhvillojë dhe të avancojë edhe aspektin e rregullimit ligjor të mekanizmave që i referohen sportit në Kosovë. Ky rregullim duhet të avancohet në përputhje me kapacitetet dhe standardet ndërkombëtare me qëllim që sportistët e Kosovës të kenë mundësi të konkurrojnë në arenën ndërkombëtare.

Krahas nevojës për trajtim dhe rregullim të sportit me dispozita përkatëse ligjore, me shumë interes ishte që *e drejta sportive* në Kosovë të trajtohet edhe në aspektin shkencor, qoftë përmes hulumtimeve, qoftë përmes përfshirjes së saj në tekste universitare dhe në plan-programe të fakulteteve të drejtësisë dhe të edukimit fizik, të cilat do të bënin të mundur që të arrihet një nivel më i lartë i njohurive lidhur me arbitrazhin sportiv në përgjithësi dhe me Arbitrazhin Ndërkombëtar Sportiv (CAS) në veçanti. Në këtë drejtim edhe trajtimi i kësaj teme në këtë libër është në funksion të këtyre dy aspekteve të sportit. I pari ka të bëjë me legjislacionin në fuqi dhe me nevojën për ndryshim e plotësim eventual të tij mbi bazën e të gjeturave dhe i dyti me aspektin shkencor të zhvillimit të sportit në Kosovë. Këto problematika që janë me interes për zhvillimin e sportit do të trajtohen në kuadër të kapitujve të këtij punimi.

Fillimisht trajtohen format e organizimit të sportit në Kosovë, përkatësisht ndarja e sportit në mekanizma organizativ, siç janë klubet, federatat, komiteti olimpik dhe, më pas, organizimi disiplinor i tyre. Pjesa tjetër, që është me shumë interes në kuadër të punimit, i referohet arbitrazhit sportiv në Kosovë, duke përfshirë organizimin, mënyrën e funksionimit, kompetencën dhe përgjegjësitë përballë sportit dhe së drejtës në Kosovë. Mbi këtë bazë do të kemi një vlerësim real të këtij mekanizmi tejet me rëndësi për disiplinimin, zhvillimin dhe avancimin e sportit në Kosovë.

Një vend të veçantë në punim do të zërë sporti kosovar si pjesë e mekanizmave ndërkombëtarë dhe CAS-it, dhe në këtë pjesë të punimit do të paraqitet funksioni, përmbajtja, kompetenca dhe mënyra se si t'i drejtohem këtij institucioni, pastaj procedurat dhe kostot që ka ky proces. Kësisoj, sportit kosovar do t'i ofrohet një mundësi e mirë që t'i njohë mënyrat se si t'i qaset CAS-it në raste konkrete.

Gjitashtu, në punim i kushtohet rëndësi edhe reformimit të klubeve, federatave dhe legjislacionit që rregullon aspektin e drejtësisë sportive. Kështu, rastet e trajtuara nga ky aspekt do të shërbejnë si precedentë edhe për rastet e tjera ku kjo pastaj do të ketë refleksion në procesin e reformimit. Poashtu do të pasqyrohen edhe të gjeturat që i referohen sportit kosovar dhe arbitrazhit vendor dhe ndërkombëtar sportiv. Trajtimi i këtyre çështjeve do të mundësojë që të kemi një pasqyrë të qartë në lidhje me gjendjen faktike dhe juridike në fushë të sportit. Në fund të punimit do të paraqiten konkluzionet si finalizim i kesja pune.



Si punë sfiduese shoh që nuk kanë mundur të trajtohen edhe çështjet që kanë të bëjnë me Organizatën Botërore të Antidopingut (WADA) dhe me Agjencinë Kosovare të Antidopingut (Kos-ADA), ndonëse një numër shumë i madh i rasteve të CAS-it vjen pikërisht nga kjo fushë. Natyrisht, jam i vetëdijshëm se në një punim të këtillë nuk kam mundur t'i përfshij të gjitha çështjet dhe problematikat juridike lidhur me të drejtën sportive dhe arbitrazhin në veçanti.

Për fund, mendojmë që kjo punë do t'u shërbejë të gjitha organizatave sportive, në mënyrë të veçantë KOK-it dhe GjAS-it. Po ashtu do t'u shërbejë edhe studentëve të fakultetit juridik dhe të shkencave sportive, por edhe Odës së Avokatëve të Kosovës, aq më tepër që nga ky institucion nuk gjendet asnjë avokat në listën e CAS-it, kurse Shqipëria ka dy avokatë të pranuar në këtë institucion ndërkombëtar.

Nga lexuesit, studiuesit dhe të gjithë të interesuarit e tjerë, mirëpres çdo mendim apo këshill profesionale e që do ti ndihmonte në vazhdimësi edhe botimet dhe punimet tjera në avancimin e sportit të vendit në të drejtën sportive-juridike.

**Fjalët kyçe:** *arbitrazh, CAS, procedurë, sport, organizatë sportive.*

## **METODOLOGJIA E PUNIMIT**

Ky punim është realizuar duke u mbështetur në metoda të ndryshme që kanë çuar në përmbushje të objektivave dhe qëllimit të këtij punimi, për t'i dhënë një kuptim të duhur aspektit shoqëror dhe juridiko-shkencor.

Metodat shkencore që janë përdorur në këtë punim të natyrës hulumtuese janë: **metoda historike, metoda analitike, metoda komparative (krahasuese), metoda e studimit të rastit dhe metoda e vëzhgimit.**

Punimi është i natyrës hulumtuese, që është një prej mënyrave themelore për realizimin e një punimi shkencor. Kjo lloj i hulumtimit bazohet në mbledhjen e materialit të nevojshëm që sjhërben si korpus hulumtimi për realizimin e objektit e studimit. Por në kuadër të punimit të kësaj natyre është bërë edhe sistemimi i literaturës përkatëse në: libra të shkruar nga autorë të ndryshëm të vendit e të rajonit dhe nga autorët ndërkombëtarë, akte juridike, burime ndërkombëtare nga e drejta sportive dhe e asaj e arbitrazhit, burime nga interneti, si dhe burime nga punime të tjera shkencore të këtij lëmi.

**Metoda analitike** – Kjo metodë bazohet në analizën e thellë të legjislacioneve dhe të drejtave që rregullojnë arbitrazhin sportiv.

**Metoda historike** – Me anë të kësaj metode arrihet që kuptohet rruga nëpër të cilën ka kaluar sporti kosovar, e drejta sportive kosovare dhe krijimi i Arbitrazhit Sportiv Ndërkombëtar.

**Metoda komparative (krahasuese)** – Është njëra nga metodat mbi bazën e së cilës është hartuar ky punim shkencor. Me anë të kësaj metode kam arritur ta realizoj njërin nga qëllimet e këtij punimi, që është aspekti komparativ i legjislacioneve që rregullojnë arbitrazhin sportiv.

**Metoda e studimit të rastit** – Përfaqëson metodën e pazëvendësueshme për realizimin e punimeve shkencore. Pra, çdo punim shkencor e ka objektin e studimit, i cili realizohet nëpërmjet kësaj metode, duke na dhënë rezultate të sakta. Në këtë punim kjo metodë zë vend mjaft të rëndësishëm duke analizuar dhe duke krahasuar bazën ligjore të arbitrazheve sportive të rajonit dhe atij ndërkombëtar (CAS) dhe duke ia propozuar GjAS-it.

**Metoda e vëzhgimit** – Duke vëzhguar rastin e parë në GjAS dhe rastin e parë të një organizate sportive nga Kosova në CAS, kam arritur t'i sjell në vëmendje të këtij punimi ato raste që do të përdoren si precedentë të Arbitrazhit Sportiv në Kosovë.

## **STRUKTURA E PUNIMIT**

Ky punim, i titulluar *E drejta sportive në Kosovë (Rruga drejt arritjes së standardeve të Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar Sportiv – CAS)*, është i ndarë në katër kapituj.

**KAPITULLI I PARË** titullohet *Arbitrazhi Sportiv në Kosovë*. Në këtë kapitull do të trajtohet forma organizative e sportit në Kosovë, duke prekur pak në historikun e organizimit të sportit në Kosovë, e në veçanti trajtohet puna rreth formimit të klubeve, pastaj federatave dhe Komitetit Olimpik. Më tutje ky kapitull flet për anën e organizimit disiplinor të këtyre OS-ve. Shtjellon mungesën e rregulloreve të disa OS-ve dhe mënyrën e parashtrimit të ankesave dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sportive brenda statuteve dhe kompetencave të tyre. Po ashtu trajtohet tema shumë e rëndësishme e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv në Kosovë, që është institucioni më i lartë i drejtësisë sportive në vend. Të gjeturat për këtë gjykatë na tregojnë këtu se kemi ende shumë punë për të bërë, pastaj jepen rekomandime për procedurat dhe për bazën ligjore të kësaj gjykate.

**KAPITULLI I DYTË** titullohet *Arbitrazhi Ndërkombëtar Sportiv (CAS)*. Ky kapitull fillon me paraqitjen e gjykatave të arbitrazhit në vendet e rajonit, duke përmbledhur disa karakteristika të secilës prej tyre. Kurse në vazhdim trajtohet më gjerësisht dhe në mënyrë precize Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar për Sport (CAS), duke filluar nga gjeneza e themelimit të saj, për të vazhduar me zhvillimin dhe avancimin e saj në kohë, reformat që ka pësuar dhe përbërjen.

**KAPITULLI I TRETË** titullohet *Rregullat procedurale*. Nga këto rregulla GjAS-i mund të marrë shumëçka si model. Në këtë kapitull shtjellohen: kompetenca e CAS-it, e drejta e zbatueshme, afatet kohore, roli i selisë së CAS-it. Trajtohet edhe mënyra e ankimimit të vendimeve të CAS-it në Gjykatën Federale Zvicerane, duke vazhduar me tarifat dhe zbatueshmërinë e vendimeve të CAS-it.

**KAPITULLI I KATËRT** mban titullin *Organizatave sportive në Kosovë dhe e drejta ndërkombëtare*. Ky kapitull me theks të veçantë flet pikërisht për krijimin, rolin dhe rëndësinë e e organizatave sportive në Kosovë, ndarjen e tyre në olimpike dhe joolimpike, mënyrën e kategorizimit nga Komiteti Olimpik, kujdesi ndaj sportistëve elitare etj. Gjatë shtjellimit të temës, do të ketë rëndësi edhe reformimi i klubeve, i federatave dhe i legjislacionit që i referohet aspektit të drejtësisë sportive, për faktin se rastet e trajtuara nga ky mekanizëm do të jenë precedentë për

rastet e tjera dhe do të kenë refleksion në reformim. Në këtë kapitull do të trajtohen edhe mosmarrëveshjet e organizatave sportive kosovare me drejtësinë e federatave ndërkombëtare apo edhe me CAS-in, duke i trajtuar disa shembuj të kësaj natyre. Dhe, gjithashtu trajtohen edhe disa triumfe diplomatike përmes sportit.

## **HYRJJE**

Me shpalljen e Pavarësisë së Republikës së Kosovës në vitin 2008, shteti i Kosovës kishte krijuar subjektivitetin e vet ndërkombëtar, gjë që ka rëndësi të veçantë në lidhje me krijimin e raporteve ndërkombëtare dhe të qenit pjesë e mekanizmave ndërkombëtarë në çdo fushë. Subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës kishte refleksion pozitiv edhe në aspektin e zhvillimit e avancimit të sportit të Kosovës e në veçanti hapi rrugë për pranimin e sporteve të Kosovës në mekanizma ndërkombëtarë sportivë. Aspirata e të gjitha institucioneve të Kosovës ishte realizuar kur sporti kosovar kishte arritur që të bëhej pjesë e mekanizmave ndërkombëtarë. Kjo e arritur ishte në funksion të avancimit të sportit të Kosovës. Sporti në Kosovë ka historinë e vet, por i kanë munguar rregullat internacionale. Pas pranimin ndërkombëtar të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK) dhe të të gjitha federatave sportive të Kosovës, sporti i Kosovës filloi të ngrihej për nga cilësia. Me këtë rast vlen të përmendet se në pjesëmarrjen e parë në lojërat olimpike Rio 2016, Kosova, përkatësisht Majlinda Kelmendi, në sportin e xhudos fitoi medaljen e artë. Kurse në LO 2020 në Tokyo fitoj 2 medalje të arta prap në Xhudo, kësaj radhe Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova. Së bashku me këtë ngritje të sportit u ngrit edhe vetëdija dhe e drejta sportive në Kosovë. Megjithëkëtë, ka ende shumë punë për t'u bërë.

Duke qenë pjesë e mekanizmave përkatës ndërkombëtarë sportivë, sporti i Kosovës ka realizuar disa të drejta, por ka edhe shumë obligime për të përmbushur standardet, gjë që është kusht kyç për të qenë i barabartë në mekanizmat përkatës ndërkombëtarë sportivë. Njëra ndër të drejtat dhe obligimet që kanë derivuar nga anëtarësimi në mekanizmat ndërkombëtarë sportivë ka qenë edhe *e drejta sportive*. Fillimisht është mundësuar që të kenë qasje në këta mekanizma ndërkombëtarë të drejtësisë sportive. Në anën tjetër tani sporti kosovar ka detyrim t'u përmbahet standardeve ndërkombëtare. Instanca më e lartë e drejtësisë sportive është Gjykata e Arbitrazhit Sportiv. Edhe Kosova, përkatësisht KOK-u, ka arritur të themelojë këtë gjykatë.

GjAS-i në Kosovë është themeluar në vitin 2001 me nismën e bordit ekzekutiv të KOK-ut në bazë të Statutit të KOK-ut dhe ishte përbërë nga 7 (shtatë) anëtarë. Mandati i arbitrave është i lidhur me mandatin e bordit ekzekutiv, pra është 4-vjeçar ku anëtarët propozohen nga federatat sportive. Kështu, në asamblenë e KOK-ut, më 24 dhjetor 2016, nga federatat ishin propozuar vetëm 9 (nëntë) kandidatë, nga të cilët është dashur të zgjidhen 7 (shtatë). Mirëpo në atë asamble u vendos

të mbeten 9 (nëntë), të cilët janë zgjedhur me aklamacion në asamblenë e përgjithshme të KOK-ut, e cila ka vazhduar me 9 anëtar edhe në asamblen e 26 dhjetorit 2020.<sup>1</sup>

Ideja për ta trajtuar temën e arbitrazhit në këtë punim ka lindur gjatë një ligjërata të profesoreshës Donikë Qerimi. Kurse, më tej, në një seminar *online* të mbajtur nga KOK-u (në kohë pandemie të virusit COVID), në të cilën vërejtja se nuk ka shumë njohuri në Kosoovë rreth arbitrazhit sportiv. Dhe nga kjo m'u qartësua ideja që pikërisht problemi i arbitrazhit sportiv të jetë temë e punimit tim, pastaj kuptova se nuk kishte as literaturë në gjuhën shqipe për këtë temë, madje as të përkthyer.

GjAS-i për herë të parë ka hartuar rregulloren procedurale, ndërsa ajo është miratuar në asamblenë e KOK-ut në dhjetor të vitit 2020. Mirëpo kjo rregullore e miratuar me 20 vjet vonesë ka shumë të meta, qofshin ato ligjore, procedurale apo edhe terminologjike. Nga ana ligjore i mungon mbështetja në ligjet e Republikës së Kosovës, siç janë: Ligji për Procedurë Kontestimore dhe Ligji i Arbitrazhit, gjithashtu edhe Konventa Ndërkombëtare e Nju-Jorkut për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj. Nga ana procedurale shumë nene bien ndesh mes vete, nuk janë të formuluar si duhet dhe sipas një rrjedhe logjike, nuk e shpjegojnë si duhet procedurën dhe është e vështirë të kuptohet nga palët e interesit. Nga ana terminologjike ka po ashtu gabime, sepse në rregullore në vend që pala e paditur të quhet palë “e paditur”, quhet “e pandehur”. Pastaj në rregullore në vend që të shkruhej se GjAS-i mund të marrë vendime edhe me anë të “ndërmjetësimit” apo “pajtimit të palëve”, thuhet se GjAS-i mund të marrë vendim edhe në “formë paqësore”. Më tej, duhet thënë se një rregullore procedurale saktësisht ndalon, kufizon apo lejon ndonjë gjë apo veprim dhe assesi nuk bën që aty të shkruhet fjala “etj.”, sepse në atë rast kjo fjalë nuk sqaron asgjë dhe krijon vetëm konfuzion.

Meqenëse GjAS-i nuk kishte rregullore të veten për 20 vjet, GjAS-i nuk kishte shqyrtuar asnjë rast të vetëm deri në gjysmën e dytë të vitit 2020 dhe në Korrik të vitit 2020 GjAS-i pranoi ankesën apo padinë e parë.

---

<sup>1</sup> [www.noc-kosovo.org](http://www.noc-kosovo.org) (Qasja në shtator 2020).

Kjo ankesë ishte nga Klubi i Volejbollit Lyboteni ndaj një vendimi të komisionit disiplinor të Federates së Volejbollit të Kosovës (FVK), me të cilin KV Lyboteni ishte përjashtuar nga garat e superligës së volejbollit. Këtë ankesë GjAS-i e shqyrtoi në mungesë të rregullores dhe përvojës.

Drejtësia sportive në Kosovë ishte e papërvojë edhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar – CAS, sepse rasti i parë i një klubi nga Kosova në CAS ishte pikërisht kah mesi i vitit 2020. Këtë ankesë e bëri FC Drita ndaj vendimit të FIFA-se, me të cilin vendim FIFA e regjistroi ndeshjen me rezultat zyrtar në dëm të FC Dritës, duke e eliminuar nga garat në Ligën e Kampionëve. Në kapitujt e kësaj libre do të shtjellohen të dyja rastet.

Arbitrazhi është instanca më e lartë e drejtësisë sportive si në vend ashtu edhe në botë, kurse kjo temë do t'i ofrojë OS-vë të Kosovës njohuri të mjaftueshme se si funksionon një gjykatë arbitrazhi.

Në vazhdim do të sjellë në vëmendje se si duhet të funksionojë GjAS-i, cila duhet të jetë baza ligjore e saj dhe se si duhet ti qasen OS-te CAS-it?

Ky punim do të jetë referencë (udhezim, rekomandim) e domosdoshme për të gjithë praktikuesit e ligjit sportiv i cili ofron një mjet interpretues për të gjithë ata që janë të interesuar lidhur me arbitrazhin sportiv.



## BIBLIOGRAFIA

1. Desphina Mavromati – Matthieu Reeb, The Code of the Court of Arbitration for Sport – Comentary, Cases and Materials. Wolters Law Kluver, 2015.
2. Iset Morina, Arbitrazhi dhe procedura e arbitrazhit. Prishtinë, 2015.
3. Luise Reilly, Jurna of Disputes Resolution. Introduction to the Court of Arbitration for Sport (CAS) & the Role of National Courts in International Sports Disputes, An Symposium. Volume 2012. Scholarship.law.missouri.edu.
4. Rrezarta Mataj, Disa trajtime mbi të drejtën sportive. Tiranë 2014.
5. Matthew J. Mitten, Judicial Review of Olympic and International Sports Arbitration Awards: Trends and observations, Pepperdine dispute resolution law journal, 2009.
6. Richard H. McLaren, Introducing the Court of Arbitration for Sport: The Ad Hoc Division at the Olympic Games, 2001.
7. Mehmet Kraja, Fjalori enciklopedik i Kosovës. Akademia e Shkencave e Kosovës, 2018.
8. Milena Petrovic, UDK 341.636:796(494)
9. Gaso Knezevic, Zbornik-Liber amicorum. Beograd, 2016.
10. Hajrullah Mustafa, Opinio Juris (revistë shkencore juridike), nr.1/2015.
11. Ece Ozsu, Erdem&Erdem Law. 2019. <https://www.mondaq.com/turkey/arbitration-dispute-resolution/781830/annulment-of-the-court-of-arbitration-for-sport-awards>.
12. Armand Krasniqi, Ligji model UNCITRAL për Arbitrazhin e Tregtisë Ndërkombëtare, <https://www.researchgate.net/>, (qasja në janar 2021).
13. Enver Tahiraj, Fjalor i sportit. Tetovë, 2020
14. Vejsel Rizvanolli – Artan Shyti, Organizimi institucional dhe juridik i sportit. Tiranë, 2011.
15. Enver Tahiraj, Fikret Shatri, Afërdita Fazlija: Raspodela sportskih sredstava u Kosovo, Crnogorska sportska akademija, “Sport Mont“ časopis br. 31,32,33. Podgorica, 2011.
16. Nenad Đurđević: Slučaj Pechstein – punovažnost odluka Arbitražnog suda za sport u Lozani ... Zbornik radova Pravnog fakulteta u Splitu, god. 54, 2/2017.
17. Ligji 03/L-006 për Procedurë Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
18. Komteti Olimpik i Kosoves, [www.noc-kosovo.org](http://www.noc-kosovo.org)
19. Federata e Volejbollit e Kosoves, <https://fvk-ks.org>

20. Ministria per Rini, Kultur dhe Sport – RKS ,[www.mkrs-ks.org](http://www.mkrs-ks.org)
21. Gjykata Nderkombetare e arbitrazhit per Sport – CAS, [www.tas-cas.org](http://www.tas-cas.org)
22. Komiteti Olimpik i Shqiperis, <http://nocalbania.org.al/ep-content/uploads/2012/02/Prezantimi-Eraldi-KAS-Tirane-16-Maj-2011.pdf>
23. Komiteti Olimpik i Serbis, <https://oks.org.rs/stalna-sportska-arbitraza>
24. Komiteti Olimpik i Malit te Zi, <http://www.cok.me/ep-content/uploads/2012/07/cok-arbitraza-pravila.pdf>
25. [http://nocalbania.org/wp-content/uploads/2012/01/Rregullore-KAS\\_ueb](http://nocalbania.org/wp-content/uploads/2012/01/Rregullore-KAS_ueb).
26. <https://oks.org.rs/akti-oks/pravilnik-o-stalnoj-sportskoj-arbitrazi-oks/>
27. Komiteti Olimpik i Maqedonis se Veriut, <https://mok.org.mk/site/sas-mok>
28. <http://nocalbania.org/ep-content/uploads/2012/01/DREJTESIA-SPORTIVE-Ilir-Panda>.
29. <https://insporti.com/kronika-e-nje-bankroti-kb-peja-ii/>
30. [www.zeri.info](http://www.zeri.info)
31. Besim Hasani, President i Komitetit Olimpik të Kosovës. (Nëntor 2020).
32. <https://www.cev.eu>BeachVolley>
33. Abedin Ibrahim, Kryetar i Federatës së Volejbollit të Kosovës. (Dhjetor 2020).
34. <https://www.chanelnewsasia.com>. Football: Spain World Cup qualifier against Kosovo overshadowed diplomatic row. 30 Mars 2021.
35. Kat Lucas. [https://www.givemesport.com/Spain-refuse-to-acknowledge-Kosovo's-name-in-World-Cup-qualifier.01.04.2021](https://www.givemesport.com/Spain-refuse-to-acknowledge-Kosovo-s-name-in-World-Cup-qualifier.01.04.2021).
36. Agim Ademi, Kryetar i Federatës së Futbollit të Kosovës. [www.ffk-kosova.com](http://www.ffk-kosova.com)
37. <https://kallxo.com>.
38. <https://editorial.uefa.com>. Regulations of the UEFA European Football Championship 2018-20.
39. Ian Marshall. <https://www.ittf.com/2019/09/27/kosovo-sets-example/>
40. Milot Berisha. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Instituti Arkeologjik i Kosovës. Guid arkeologjike e Kosovës. Prishtinë 2012. Faqe 55.
41. Recueil Officiel des Arrêts du Tribunal Federal Suisse, Chapeau 119 II 271, 15 Mars 1993.